



A.nr. 2003/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2003/2025, të datës 09.12.2025, të parashtruar nga ankuesi A.L nga Peja, në çështjen juridike – administrative “*masës disiplinore-ndalesë e pagës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 22.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprobuhet si e bazuar** ankesa me numër A.nr. 2003/2025, e datës 09.12.2025, e parashtruar nga ankuesi A.L.
- II. Anulohet** Vendimi KD:02/2025, i datës 14.11.2025, i Komisionit Disiplinor i Agjencisë për Menaxhimin Emergjent.
- III. Obligohet** Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të verimit të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative në mënyrë që ankueses ti bëhet kompensim i diferencës së pagës të ndaluar sipas vendimit të komisionit disiplinor të anuluar si në pikën II të dispozitivit dhe heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e ankuesit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi

A r s y e t i m

Ankuesi A.L (*tutje referuar ankuesja*), më datë 09.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD:02/2025, të datës 14.11.2025, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 19.12.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, ndërsa,

kjo e fundit, më datë 24.12.2025, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës, duke dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7788/2025 të datës 09.12.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin KD:02/2025 të datës 14.11.2025 të Komisionit Disiplinor të AME; Përshkrimin në fletore pune datës 28.09.2025;; Evidentimin e rastit në ditarin e punës datë 28.09.2025; Emalin e dërguar nga B.L; Emalin e datës 16.11.2025 nga ankuesi për Personelin e AME-se; Formularin për qasje në dokumentet publike datës 04.12.2025 nga ankuesi; Emalin e datës 04.12.2025 nga ankuesi për info.AIP; Emalin e datës 23.11.2025 te ankuesit për Personelin e AME; Emalin e datës 06.10.2025 te ankuesit drejtuar Personelit në AME; Raportin e menjëhershëm te incidentit te datës 28.09.2025; Dokumentin e identifikimit te ankuesit; Kërkesën për përgjigje ne ankese te datës 24.12.2025; Vendimin me numër 22/2020 te datës 06.04.2020 për transferim; Procesverbalin e komisionit disiplinor; Emalin e datës 01.10.2025;; Vendimin me numër 109/2024 të datës 05.12.2024; Emalin e datës 29.09.2025; Emalin e datës 06.10.2025; emalit e datës 01.10.2025, 03.10.2025, 06.10.2025; Emalin e datës 14.10.2025, 15.10.2025; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Operator i QOE 112;

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e babazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se Ankuesi sipas vendimit me numër 22/2020 të datës 06.04.2020 nga departamenti i financave dhe Shërbimeve të Përgjithshmen në AME është transferuar nga pozitën e punës Operator në Qendrën Operative Rajonale 112 në Pejë.

- Koordinator i Qendrës operative Emergjente 112, në Pejë, më datë 29.09.2025, i është drejtuar me emal Drejtorit të Departamentit të Operative, me kërkesë se *me rastin e mbyttjes së një personi në bunar në Lubeniq, nga operatorët e QOE112 nuk janë respektuar procedurat dhe standardet operative me çka është bërë shkelje e rëndë e të njëjtave. Së pari informacioni është pranuar në orën 14:44 nga numri 044 424 464, dhe është kërkuar ndihmë për intervenim në shpëtimin apo nxjerrjen e personit të mbytur në bunar. Në orën 14:45 janë njoftuar pjesëtarët e SHZSH-së, të cilët kanë dal menjëherë në vendin e ngjarjes por më tutje nuk janë proceduar veprimet e parapara me PSO. Procedurat e parashohin që pas ardhjes në vendin e ngjarjes të kontaktohet shërbimi për situatën dhe të kërkohej udhëzime apo nevoja për mbështetje-nuk është bërë. Të kontaktohet shefi i QOE 112 dhe të njoftohet për situatën -nuk është bërë. Të njoftohet nivelit qendror respektivisht QOAME apo personalisht z. I.K apo M.C-nuk është bërë. Të përcjellët situata dhe të ju sigurohet mbështetje në vendin e ngjarjes-nuk është bërë, as që është regjistruar farë në ditarin operativ si rast. Thirrje e njësisë nga Deçani për ndihmë apo mbështetje-nuk është marr parasysh e as që janë konsultuar ekipet në teren. Raporti emergjent është dërguar me kohë pro është bërë pas intervenimit tim dhe ardhjes së ndërrimit tjetër në orën 20:00. Andaj duke u bazuar në të gjitha shkeljet e procedurave, e cila nuk janë e para, e që ka të bëjë me operatorët V.SH dhe A.L, gjë për të cilën jeni njoftuar disa herë, kërkon që të merren masa.*

-Drejtori i Departamentit të Operativës përmes emalit të datës 29.09.2025, i është drejtuar Menaxherit të Personelit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, që rasti të procedohet në Komisionin Disiplinor sipas

Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ndërsa nga Personeli i AME më datë 01.10.2025, rasti është përcjell tek Komisioni Disiplinor.

- Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, më datë 14.11.2025, ka nxjerr Vendim KD: 02/2025, me të cilën ankuesin e ka bërë përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore të parapara me nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore *“ndalim në pagë në vlerën 20% të pagës bruto për një periudhë 1 (një) muaj”*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimin KD:02/2025, të datës 14.11.2025 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, se nuk jam ftuar nga eprori për asnjë sqarim. Të gjitha organet tjera kishin informatën para se të marr 112, dhe rasti nuk ka qenë përmes qendrës 112 në Pejë këtë e vërteton edhe raporti emergjent që është dërguar në AME. Mos regjistrimi i rastit në librin e shërbimit nuk ka ndikuar në trajtimin e rastit, sepse ka qenë rezultat i një vlerësimi profesional dhe jo i neglizhencë, sepse veprimet e mia kanë qenë në përputhje me detyrën e operatorit për të siguruar se rasti të përcillet tek institucionet përgjegjëse gjë që ka ndodhur pa vonesë. Mos njoftimi i Koordinatorit nuk ishte neglizhencë por u bazua në faktin se reagimi tashmë ishte në proces dhe organet kompetente ishin të pranishme. Kam qenë në krye të detyrës dhe veprimet e mia kanë qenë në pajtim me procedurat, ndërsa ndëshkimi nga Komisioni Disiplinor është bërë pa të drejtë pa një bazë juridike dhe pa një gjendje faktike. Kërkon të anulohet Vendimi i Komisionit Disiplinor i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë: - Neni 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”*.

- Neni 56, paragrafi 1 dhe 4: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit*

të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

- Nenit 57 paragrafi 2: “Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: **2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj;** 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.

-Nenit 61 paragrafi 1: 1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunës/it për shmangien apo kufizimin e dëmit.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka analizuar Vendimin KD:02/2025, të datës 14.11.2025, të Komisionit Disiplinor të AME-së në ndërlidhje me provat tjera materiale të parashtruar nga palët në procedurë, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj se Komisioni Disiplinor ka dhënë vetëm konstatime të përgjithshme që ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, duke mos argumentuar bazën ligjore që përcaktojnë se veprimet apo mosveprimet e ankesës përbëjnë shkelje të rëndë disiplinore, cilat janë pasojat dhe dëmi i pësuar nga veprimet / mosveprimet e ankuesit dhe nëse ankuesi me parë ka pas në fuqi ndonjë masë disiplinore, rrethana këto që në vlerësimin e Kolegjit përbejnë fakte relevante për vërtetimin të drejtë dhe të plotë të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit dhe shqiptimit të masës disiplinore në proporcion më shkeljen e ndodhur. Andaj, Kolegji i Këshillit, në mbështetje të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: “**Neni 88 1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen. Neni 89 Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ**”, vlerëson se Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, me vendimin e atakuar më ankesë nuk ka arrit të argumentoj në mënyrë bindëse se në veprimet/mosveprimet e ankueses manifestohen elementet e shkeljes se rëndë disiplinore sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.NR.2003/2025**

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.L;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.